

Rezolute

Drejtuar:

***Kryeministrise
Parlamentit
Ministrise se Bujqesise & Ushqimit
Ministrise se PL & Decentralizimit
Drejtore se Pergjithshme te Pyjeve & Kullotave
Njesise se Menaxhimit***

Per dijeni:

***OSCE, WB, WFP, SNV, PartnersAlbania
Projektit FAO-TA
Keshillit te Qarkut Diber
Prefektures se Qarkut Diber
Federates Kombetare te Pyjeve dhe kullotave ne Tirane***

Federata e Pyjeve dhe Kullotave Komunal Qarku Diber, qe perbehet nga 19 Shoqata te Pyjeve dhe Kullotave Komunal dhe 15 Komuna ka per mission, te percjelle interesat e anetareve per menaxhimin e qendrueshem te pyjeve e kullotave komunal nepermjet koordinimit, keshillimit dhe mbeshetjes ne pergjithesi te interesave te tyre.

Me date 17/10/2003 ne Bulqize u mbajt nje seminar qe ne fokus kishte "Partneritetin dhe Qendrueshmerine". Ne kete seminar u diskutua ne lidhje me Zhvillimin e Qendrueshem, Mjedisin e Qendrueshem dhe Decentralizimin duke marre parasysh eksperiencen e deritanishme dhe sfidat per te ardhmen.

Ne Qarkun e Dibres, gjate kater viteve te fundit jane transferuar nga Shteti ne perdorim te fshatrave dhe komunave pyjet dhe kullotat komunal ne 22 Komuna, ku ne pergjithesi ne keto terriore, nen kujdesin e komunitetit strukturat e ndertuara ne nivel komunash kane ndikuar ne mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve ne nivel Qarku.

Pyjet e lisit por edhe ato te ahut nga Skuraj te Milotit deri ne Kalane e Dodes se Korabit, kane pesuar ndryshime. Ato ne shume zona kane arritur te mbyllin masivin dhe kane patur ndikime te rendesishme ekonomike dhe ekologjike per gjithë rajonin. Ndikime te ndjeshme ka patur riparteritja e tradites ne menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunal ne afersi te fshatrave per te cilen kontribut ka dhene edhe projekti i Pyjeve te Bankes Boterore me Drejtorine e Pergjithshme te Pyjeve dhe Kullotave (DPPK).

Bazuar ne pervojen e deritanishme dhe nga diskutimet e opinionet e dala nga seminari u vendos qe:

Te mbeshtese: Dekleraten e Ministrit te Bujqesise dhe Ushqimit per hartimin e nje strategjie te re per pyjet dhe kullotat, e cila do te konsistoje ne shtimin dhe mbareshtimin e pyjeve e kullotave si dhe ne ndalimin e prerjeve te lendes se drurit per tregti. Ne reformen e metejshme institucionale dhe ne hartimin e nje kuadri te ri ligjor ne harmoni me ligjet e tjera.

Te sugjeroje: Gjate hartimit te kesaj strategjie dhe te ligjeve te reja per pyjet e kullotat te perfshihen dhe merren mendimet dhe eksperiencat e mira qe Shoqatat e Perdoruseve te Pyjeve e Kullotave Komunal, Federatat, Komunat dhe Drejtorite e Sherbimeve Pyjore te rretheve kane ne kete drejtim. Kjo perfshirje te behet qe ne hapat e para, pasi eksperineca ka treguar qe strategji dhe ligje te bera nga "specialiste dhe shkencetare" qe rrine brenda kater mureve te zyrove jane te deshtuara.

Te kerkoje:

- **Keshillit te Ministrave** qe :
- Te njihet pronesia private per Komunat dhe individe, mbi pyjet dhe kullotat komunal te transferuara, pasi eksperienca e deritanishme ka treguar qe eshte menyra me e mire per menaxhimin e qendrueshem te tyre.
- Transferimin e kullotave alpine ne perdorim ose pronesi te Komunave.
- Te pershpjtohen procedurat e zbatimit te ligjit 8744 te dates 22.2.2001
- Te njihet prona private per te gjitha perdoruesit
- **Ministrise se Bujqesise & Ushqimit si dhe Ministrise se Pushtetit Lokal & Decentralizimit** qe, transferimi i pronave te shoqerohet me mjete monetare per mirembajtjen e tyre, te Pushteti Lokal, Komunave
- **Ministrise se Pushtetit Lokal & Decentralizimit** qe, te beje vendosjen e eksperteve ne nivel komune dhe kjo te jete e shoqeruar me te gjitha detyrimet ligjore dhe financiare.
- **Ministrise se Bujqesise & Ushqimit** per ndryshimin e rregullores 308, per pyjet dhe kullotat komunal.
 - Mbi te drejtat e perdorimit te burimeve pyjore
 - Perfshirja e Pushtetit Lokal dhe shoqatave ne aktivite ekonomike
 - Kalimi drejt ekonomise se tregut per tregetimin e te gjitha produkteve te pyjeve dhe kullotave per nevojat e vete Komunes si dhe krijimin e fondit te riinvestimit.
- **Parlamentit** qe te permiresoje sa me shpejt ligjet e GJUNETISE, te KULLOTAVE dhe per MBROTJEN E FONDIT TE BIMEVE MJEKESORE, duke perfshire komunitetin dhe vullnetin e shumices qe ne hartimin e tyre.

Nga: **Federata e Pyjeve & Kullotave Komunal Qarku Diber, me anetare:**

Komunat: Kala e Dodes, Sillove, Luzni, Tomin, Kastriot, Melan, Maqellare, Ostren, Gjorice, Lis, Suç, Ulez, Rukaj, Macukull, Komsi

Shoqatat: Suç, Lure, Lis, Melan, Gjorice, Rukaj, Ulez, Muhurr, Macukull, Ostren, Sillove, Kastriot, Kala e Dodes, Tomin, Shimçan, Maqellare, Komsi, Zerqan, Arras 1, Arras 2

Per federaten, nenshkruset nga:

Kryetari:

Nen-kryetari:

Ylli Meta

Zenel Shehi